

**INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR
 KREDISË HIPOTEKARE TE SIGURUAR ME KOLATERAL “Flexi
 Collateral“ - [REDACTED]**

Prezantim	Ky informacion përbën një prezantim të ofertës që Banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut. Ky informacion nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Dhënia e informacionit sipas këtij dokumenti nuk parasheh detyrimin e Bankës për të akorduar kredi.
1. Banka	“ Banka e Pare e Investimeve ”, ALBANIA Sh.a Adresa: Bulevardi “Deshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 2, kati 14, Tiranë. Adresa e Web-it: www.fibank.al Telefoni pa pagese 08000111: Tel 042276702/3; Fax: 042280210
2. Emri i Produktit	Kredi Hipotekare te siguruar me kolateral “ Flexi Collateral “ [REDACTED]
3. Qëllimi i produktit, afati dhe monedha	Kredia hipotekare “Flexi Collateral“ [REDACTED] që jepet nga FIBANK sha ka si qëllim plotesimin e kërkesave dhe nevojave financiare të klienteve individ apo dhe Personave Fizike me deklaram vjetor nën 14 mio lekë të cilët duan të blejnë një pronë nga kompania [REDACTED] Shuma maksimale e kredise është 70% e vlerës së tregut të kolateralit Afati maksimal deri në 240 muaj (20 vjet) Monedha : Lekë; EUR Shuma maksimale: EUR [REDACTED] ose shuma ekuivalente ne Leke
4. Përshkrimi i produktit	Kredia hipotekore e siguruar me kolateral “Flexi Collateral“ [REDACTED] është kredi e pagueshme me këste të barabarta mujore e cila ju jepet individeve/ Personave Fizike kundrejt lënies si garanci hipoteke pronen e ardhshme te ndertuar nga shoqeria [REDACTED], duke hipotekuar kontraten e porosise se nenshkruar midis klientit dhe kesaj shoqerie ose kolateral te ofruar nga kompania [REDACTED]. Banka financon deri në 70% të vlerës së kontrates se porosise se nenshkruar midis klientit dhe shoqerise. Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste të barabarta mujore (kryegjë + interes) sipas aneksit të shlyerjes.
5. Garanci/siguri të nevojshme	Sende të hipotekueshme ne fazen e ndertimit nga shoqeria [REDACTED]. Garancia do të vleresohet sipas cmimit te kontrates se sipermarrjes dhe duhet te mbuloje ne masen minimum 143% te shumes se kredise qe klienti kerkon te marre . Per shembull: Nese ju kerkoni nga Banka nje kredi me vleren 70.000 Euro atehere vlere e prones se vene si garanci duhet te jete te pakten 100.000 Euro Raporti i vlerësimit të pasurive të paluajjtshme kryhet nga vlerësues të pavarur të sygjeruar nga banka dhe kjo kosto mbulohet nga aplikanti. Ky raport vleresimi do te kryhet ne momentin e regjistrimit perfundimtar ne Agjensine Kombetare te Kadastrave te prones se fiancuar nga banka.

6. Norma e Interesit

➤ Per banim

LEKË :

3.49% vitin e parë ;Bono Thesari 12M + 1.99%, jo më pak se 4.99% për vitet në vazhdim

EUR:

2.99% vitin e parë ;Euribor 12M + 2.49%, jo më pak se 4.99 % për vitet në vazhdim

➤ Per investim

LEKË :

3.99% vitin e parë ;Bono Thesari 12M + 2.49%, jo më pak se 4.99% për vitet në vazhdim

EUR:

3.49% vitin e parë ;Euribor 12M + 2.99%, jo më pak se 4.99 % për vitet në vazhdim

• Per kategorine emigrant/te huaj

LEKË :

3.99% vitin e parë ;Bono Thesari 12M + 2.99%, jo më pak se 4.99% për vitet në vazhdim

EUR:

3.99% vitin e parë ;Euribor 12M + 2.99%, jo më pak se 4.99 % për vitet në vazhdim

Interesi i shprehur me siper do te jete + 0.75% deri ne momentin e rregjistrimit te pasurise se financuar nga banka jone dhe bllokimin e saj ne favor te Fibank.

**Bazuar ne vleresimin e riskut te rastit, norma e interesit mund te rritet deri ne 3%. Disa faktore qe mund te ndikojne ne kete rritje jane:

- Raporti i mbulimit me kolateral eshte me i ulet se ai i kerkuar nga produkti
- Te ardhura jo te diversifikuara
- Nuk ka garantor

5.1 Pagesat e interesit të përcaktuara në planin e shlyerjes përlllogaritet mbi principalin e kredisë në bazë të EURIBOR-it vjetor/ Bonove 12 mujore të thesarit në momentin kur do të nënshkruhet kontrata dhe nuk pasqyron masën e plotë të interesit të detyruar për cdo periudhë interesi por ka karakter orientues.

5.2 Banka përlllogarit cdo ditë interesin real të detyruar mbi pjesën e pashlyer të kredisë. Interesi real i detyruar përlllogaritet në bazë të EURIBOR-it vjetor/ Bonove 12 mujore të thesarit i publikuar, për ditën përkatëse të llogaritjes plus shtesat si më sipër.

Banka mbledh ose kthen diferencën ndërmjet interesit të llogaritur midis pikës 5.1 dhe 5.2 ne rastet kur:

- Në datën e maturimit të pagesës së fundit të interesit të përcaktuar në planin e shlyerjes
- Në rast të ridiskutimit të kushteve të kontratës së kredise me Kredimarrësin
- Në rast të shlyerjes së pjesshme para afatit ose të shlyerjes se plote të detyrimeve të Kredimarrësit
- Banka me iniciativen e saj në datën e maturimit të pagesës së interesit të përcaktuar në planin e shlyerjes ; me iniciativen e saj në datën e maturimit të pagesës së interesit përkatës

Interesat përkatëse dhe shumat e tjera të detyrueshme për Huamarresin do të llogariten në bazë të diteve efektive, duke pranuar vitin me 360 ditë

Normat Eur 12M/Bono Thesari 12 M jane te publikuar ne faqen LIBOR te REUTERS ne ditën qe i korrespondon 12 muaj pas dates se disbursimit te kredise/norma baze e interesit e publikuar ne faqen zyrtare te Bankes se Shqipërisë ne ditën qe i korrespondon 12 muaj pas dates se disbursimit te kredise

<p>7. Norma efektive e interesit (NEI)</p>	<p>Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e limitit të kredisë të dhënë dhe e llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores së Bankës së Shqipërisë “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare financiare”.</p> <p>Për qëllime të llogaritjes së NEI totali i kostos së kredise nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes së NEI: shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në kontratë, kostot lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tretë(psh pagesat noteriale, bllokimit, etj) dhe cdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë apo shpenzime për ndryshim të kushteve kontraktore.NEI do të llogaritet me supozimin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrata është e vlefshme për periudhën e rene dakord dhe • Palet plotesojnë detyrimet e tyre sipas kushteve dhe datës së rene dakord në kontratën e kredisë dhe • Përqindja e interesit dhe shpenzimet e tjera që përfshihen në llogaritjen e NEI mbeten të pandryshuara deri në fund të kontratës së kredisë
<p>8. Afati/Shuma maksimale dhe monedha e kredisë</p>	<p>Afati maksimal: 20 vjet</p> <p>Shuma maksimale: EUR [redacted] ose shuma ekuivalente ne Leke</p>
<p>9. Vlera e kredisë dhe monedha ne cilen kerkohet</p>	<p>[redacted]</p>
<p>10. Kohezgjatja e kontrates se kredise</p>	<p>[redacted] muaj</p>
<p>11. Plani i amortizimit</p>	<p>Numri dhe frekuenca e pagesave = [redacted] keste te barabarta mujore</p> <p>Vlera e cdo kesti = [redacted] [redacted]</p> <p>NEI = [redacted] %</p> <p><i>Pëllogaritja e NEI-t është pjesë integrale bashkangjitur këtij dokumenti.</i></p>
<p>12. Nëse është e aplikueshme Kredia është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ne monedhe te ndryshme nga te ardhurat ○ Ne te njejten monedhe me te ardhurat
<p>13. Nëse është e aplikueshme Vlera e këstit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë.</p>	<p>Ju do të merrni një njoftim në rastet kur, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, si psh</p> <ul style="list-style-type: none"> - kësti i kredisë [50.000 lek] tejkalon vlerën [60.000 lek] nese te ardhurat jane ne lek kredia ne euro - kësti i kredisë [400 euro] tejkalon vlerën [480 euro] nese te ardhurat jane ne euro kredia ne lek <p>Ju do të keni mundësinë të konvertoni kredinë në monedhen ne te cilen keni te ardhurat nëse si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kësti i kredisë rritet me shume se 20% sesa kundërvlera e këstit që do të rezultonte nëse do të aplikohej kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në datën e nënshkrimit të kontratës.</p>

	Konvertimi mund të kryhet bazuar në rezultatet e analizës apo të vlerësimit më të fundit të bankës, mbi monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat
14. Shuma totale qe konsumatori do te kete per te paguar	Shuma e totalit te kredise = [] [] (Vlera e Kryegjese + Vlera e Interesit + Vlera e Komisionit te manaxhimit te kredise + Vlera e komisionit te aplikimit + Vlera e mbajtjes se komisionit te llogarise + Shpenzime noteriale + Shpenzime Hipotekore + Kosto Sigurimi Kolaterali)
15. Tërheqja e fondeve	Tërheqja e kredisë do të bëhet në nje nga mënyrat : 1.Me ane të tërheqjes në të holla 2.Me ane të urdher pageses së dhënë me shkrim në favor të të tretëve 3.Me ane të mjeteve elektronike 4.Sipas mënyrës së rëne dakort në kontratë Kur banka konstaton së Kredimarresi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e kredisë nënshkruar nga palet, Banka ka të drejtë të kërkoje kthimin e menjehershëm të shumës së kredisë dhe të gjithë detyrimeve të lidhura me të përmes një njoftimi me shkrim nga ana e bankës.
16. Kosto shtesë e detyrueshme për përfitimin e kredisë	<ul style="list-style-type: none"> • Komision aplikimi: [] [] • Komision menaxhimi: [] % mbi shumën e kredisë kur kredia miratohet • Vleresimi i pronës (ne momentin e rregjistrimit te prones ne ASHK): [] • Kosto noterizimi (perfshire edhe kostot e noterizimit te kontrates se hipotekes pas rregjistrimit te prones ne ASHK): <ul style="list-style-type: none"> ➢ Kontrata e kredisë: [] Leke ➢ Kontrata e hipotekes: [] Leke • Kosto bllokimi prone në hipotekë (perfshire edhe kostot e bllokimit te prones pas rregjistrimit te prones ne ASHK): [] Leke <p>Këto shpenzime jane të pashmangshme dhe ekzekutohen vetëm një here.</p>
17. Shlyerje para afatit të maturimit	Banka do të pranojë mbyllje të parakohshme të huasë, të pjesshme apo totale të principalit përkundrejt një pagese prej <ul style="list-style-type: none"> • 2% e shumës së paguar para afatit nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi një vit • 1% e shumës së paguar para afatit nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë nuk kalon një vit
18. Kosto shtesë te tjera	Në rast të aprovimit të aplikimit për kredi klienti duhet të paguajë kosto të tjera shtesë: <ul style="list-style-type: none"> • Sigurim prone: [] [] <p>Këto shpenzime janë të pashmangshme dhe të detyrueshme përpara disbursimit të kredisë. Primet e policave të sigurimit të pronës përseriten cdo vit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kosto e mbajtjes së llogarisë: Për celjen e llogarisë së kredisë dhe për transaksionet që do të kryhen me këtë llogari lidhur me lëvrimin e kredisë dhe kryerjen e pagesave për ripagimin e kredisë, Banka do të aplikojë komisionet në masën prej 100 lekë/1 EUR ne muaj . Në rast Personi Fizik, komisionet janë 150 lekë/1 Eur.

<p>19. Mundësia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit)</p>	<p>Klienti ka të drejtë të kërkojë zëvendësimin e kolateralit nëse plotëson kushtet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në momentin e kërkesës për një periudhë prej 6 muajsh para saj, të mos ketë status kredie ose vonese në regjistrin e kredisë si kreditor primar ose si palë e lidhur - Në FiBank mos të ketë detyrim të papaguar për kreditë e veta ose si palë e lidhur - Prona që do të ofrohet si kolateral i ri të jete rezidenciale me një vlerë tregu sipas rregullave në fuqi të bankës në momentin e kërkesës - Prona duhet të jete e hipotekueshme dhe duhet të plotësojë edhe kërkesat e dokumentacionit ligjor të kërkuar <p>* Vendimmarrja në zëvendësimin e kolateralit është subjekt aprovimi sipas rregullores të brendshme të bankës</p>
<p>20. Nëse është e aplikueshme Produkte/shërbime shtesë:</p>	<p>Informacion mbi produktet/shërbimet shtesë të ofruara nga banka: Kjo kredi është e lidhur me një llogari rrjedhese të klientit, llogari e cila ofrohet në përputhje me termat dhe kushtet në fuqi të Bankës në datën e hapjes së saj</p>
<p>21. Njoftimi zyrtar midis palëve</p>	<p>Të gjithë njoftimet komunikimet midis palëve do të behen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë në adresën e përcaktuar në kontratën e kredisë ose kur është e mundur me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (email, disket, CD ROM, DVD, kuti postare etj)</p> <p>Kredimarrësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 ditëve kalendarike për këto ndryshime. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bera në adresën e mëparshme.</p>
<p>22. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë</p>	<p>Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga Kontrata e kredisë brenda një periudhe kalendarike 7 ditore nga dita e nënshkrimit të kontratës së kredisë. Përpara ushtrimit të kësaj të drejte Kredimarrësi duhet të njoftojë Bankën brenda periudhës së sipërpërmendur. Në rast se Banka ka disbursuar shumën e kredisë Kredimarrësi është i detyruar të kthejë shumën e kredisë, interesat për ditët përkatëse si dhe shpenzimet e kryera nga Banka në funksion të disbursimit të kredisë</p>
<p>23. Ankimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ankese me shkrim pranë çdo dege • Nëpërmjet telefonit: <p>Telefono pa pagesë 08000111 Tel 042276702/3 Fax: 042280210</p>
<p>24. Penalitete të tjera</p>	<p>Në rast se kredimarrësi nuk përmbush detyrimet e parashikuar në kontratën që do të firmoset dhe /ose nuk ka siguruar fonde të mjaftueshme në llogarinë e tij për pagesën në kohë të këstit të kredisë, banka aplikon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. interesi sipas pikës 5 plus shtesën prej 20 (njetzet) njësisish. (Kryegjë në vonesë * {interesi vjetor +20}/360*ditët në vonesë) 2. mbi shumën e tërë principalit të pamaturuar normën e interesit të pikës 5 plus shtesën prej 1% pergjatë gjithë periudhës që kredimarrësi do të jete në shkelje apo mospërmbushje të një prej detyrimeve që rrjedhin nga kontrata që do të firmoset mes palëve

25. Kosto të tjera që rrjedh nga kontrata e kredise	Komision per ndryshim te kolateralit me kerkese te klientit, per ndryshime ne kontraten e kredise eshte 0.25% e shumese se principalit te pamaturuar, jo me pak se EUR 50.
26. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit	Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti

ANEKSI ME POSHTE ESHTË I VLEFSHEM VETEM PER ATA KLIENTE QE APLIKOJNE PËR KREDI NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO NË TË CILËN GJENEROJNE TË ARDHURAT

SHEMBULL ILUSTRUES PËR RREZIKUN E KURSIT TË KËMBIMIT PËR KREDINË NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO E GJENERIMIT TË TË ARDHURAVE	
Tekst sqarues për konsumatorin	
<p>Kredidhënia në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat, për konsumatorin që nuk është i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shembull, një nënçmim i fortë i kursit të këmbimit, do të shkaktonte vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer kredinë. Këto vështirësi mund të çonin në dështimin e konsumatorit për të shlyer kredinë, në kthimin e kredisë në statusin “me probleme”, dhe mund të përfundonin në fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrimit nga ana e bankës.</p> <p>Ky aneks përmban një shembull me natyrë ilustruese dhe informuese, dhe nuk përfaqëson një pritshmëri apo angazhim ligjor nga kredidhënësi apo kredimarrësi.</p> <p>Konsumatori që aplikon për kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti vërteton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) e ka marrë këtë dokument nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredisë; 2) e ka kuptuar shembullin dhe efektet e mundshme nga lëvizjet në kursin e këmbimit; 3) është i bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë. <p>Dokumenti i nënshkruar është pjesë e analizës që bën banka për dhënien e kredisë tek konsumatori, por dokumenti i nënshkruar nuk e detyron bankën për dhënien e kredisë dhe as nuk e redukton përgjegjësinë që ka banka për të kryer analizën e saj të plotë për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për kredi.</p>	
Të dhëna për kredinë në monedhë të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave	
<p>Kredimarrësi:</p> <p>Kredidhënësi: FiBank Albania</p> <p>Lloji i kredisë: Kredi Hipotekare “Flexi Collateral”</p> <p>Kohëzgjatja e kredisë:</p> <p>Vlera e kredisë:</p> <p>Njësia monetare:</p> <p>Kursi i këmbimit, në datën e vlerësimit të planit ilustrues:</p> <p>Kundërvlera e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat:</p> <p>Norma efektive e interesit:</p> <p>Indeksi orientues/norma referencë:</p> <p>Marzhi:</p> <p>Të ardhurat mujore (bruto/neto) të huamarrësit në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit):</p>	

Tabelë 1: Kësti i kredisë dhe raporti i vlerës së këstit të kredisë ndaj të ardhurave (në %), sipas skenarëve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit. - Bashkëngjitur

Shembull i kestit te kredise dhe raporti i vleres se kestit te kredise ndaj te ardhurave (%), sipas skenareve te rrezikut te ndryshimit te kursit te kembimit. Rasti kur kredia jepet ne EUR dhe te ardhurat jane ne LEK

Skenari	Vlera e kestit e shprehur ne monedhen e kredise (eur) Kesti: 200 (a)	Kundervler e e kestit ne monedhen ne te cilen gjenerohen te ardhurat (leke) (b)	Të ardhurat (mesatare mujore të 3 viteve të fundit) në monedhën në të cilën ato gjenerohen (leke) (c)	Raporti i vlerës së kestit ndaj të ardhurave (d) = (b)/(c)
Kursi i këmbimit nuk ndryshon (kursi Eur/Lek ne daten e marrjes se informacionit per kredi)	130	26 000	90 000	28.8%
Nënçmimi i kursit të këmbimit me 5% (i supozuar ne te ardhmen)	137	27 400	90 000	30.44%
Nënçmimi i kursit të këmbimit me 20% (i supozuar ne te ardhmen)	156	31 200	90 000	35%

DEKLARATË PËLQIMI MBI PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA AUTORITETI I KONKURRENCËS

Në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Fibank Albania sh.a. (në vijim “Banka”) informon se, në rastet e parashikuara nga ligji dhe në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj, informacioni dhe dokumentacioni që lidhet me marrëdhënien e kreditimit mund t’i vihet në dispozicion Autoritetit të Konkurrencës (në vijim “Autoriteti”) në kuadër të aktiviteteve të monitorimit, hetimeve paraprake ose hetimeve të thelluara.

Ky dokumentacion mund të përmbajë të dhëna personale të kredimarrësit, garantuesve, përfaqësuesve ligjorë dhe personave të tjerë të lidhur me marrëdhënien kontraktore. Autoriteti mund të aksesojë dhe përpunojë këto të dhëna vetëm në masën e nevojshme për ushtrimin e kompetencave të tij ligjore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Banka ka detyrimin ligjor të vërë në dispozicion të Autoritetit informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, ndërsa Autoriteti do t’i përpunojë të dhënat vetëm për qëllimet e përcaktuara me ligj.

Pasi u informova mbi qëllimin e përpunimit, bazën ligjore dhe të drejtat e mia në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale:

- Jap pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale nga Autoriteti i Konkurrencës.
- Nuk jap pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale nga Autoriteti i Konkurrencës.

Konsumatori/ët

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

Data e nënshkrimit

(____/____/20____)